



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:245837

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874749

KPPP.nr.1855/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Dëlrirë Cleaning CO” SH.P.K., me NUI:811481233, me seli në Prishtinë, rruga “Trepça” nr.17, përfaqësuar sipas autorizimit nga Arsim Krasniqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Gorani Med” SH.P.K., me NUI:811880493, me seli në Prishtinë, rruga “Richard Hollbruk”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Florian Petani, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.723/23 të datës 09.10.2023 të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Gorani Med” SH.P.K., ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.723/23 i datës 09.10.2023, i Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Dëlrirë Cleaning CO” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.723/23 të datës 09.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës Nr.42/2023 të datës 31.07.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri, kreditorit t’ia paguajë shumën prej 1,239.00 €, me kamat ligjore 8% nga dita e caktimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, dhe ato të përpilimit të propozimit për përmbartim shumën prej 104.00 €, për përpilimin e përgjigjes në prapësim shumën prej 104.00 € si dhe për ankesë shumën prej 104.00 €, ashtu që përmbushja

e detyrimit të bëhet edhe me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është marrë urdhri përmbartimor nuk ka titull ekzekutiv si dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, për shkak të mungesës së tipareve të përmbartueshmërisë, pasi që e njëjta nuk është e nënshkruar e as e vulosur nga ana e debitorit. Tutje ka shtuar se propozimi për përmbartim është i palejuar pasi që të njëjtit i është bashkangjitur fatura në kopje e cila nuk është vërtetuar sipas ligjit, ndërsa pretendimi i kreditorit se faturën debitorit i'a ka dorëzuar përmes postes nuk qëndron pasi që fletëkthesa e cila është bashkangjitur në shkresat e lëndës nuk përmban asnjë referencë të vetme lidhur me numrin e pranimit të dërgesës postare, çka pamundëson objektivisht identifikimin e dërgesës postare. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbartimor, si dhe ta detyroj kreditorin që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të prapësimit në shumë prej 104.00 €.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim me të cilin ka deklaruar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i parashtruar jashtë afatit ligjor. Tutje ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit sa i përket dokumentit përmbartimor pasi që debitori paraprakisht ka pranuar shërbime nga kreditori dhe se i njëjti faturën e cila është objekt i kësaj procedure përmbartimore e ka pranuar përmes postës me datë 19.09.2023, e cila vërtetohet nga fletëkthesa postare, po ashtu fatura është dorëzuar në origjinal andaj nuk qëndrojnë as pretendimet e debitorit se fatura është bashkangjitur në kopje të thjesht. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor si dhe ta detyroj debitorin që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet e përgjigjes në shumë prej 104.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit

është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura me Nr.42/2023 e datës 31.07.2023, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit e as vulën e debitorit si dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në cilëndo formë.

Gjykata vlerësoi pretendimin e kreditorit se fatura në rastin konkret i është dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit përmes postës, duke bashkëngjitur si dëshmi fletëkthesën e datës 19.09.2023, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se nga fletëkthesa me numër e datës 19.09.2023, tek pjesa lloji i dërgesës nuk është evidentuar lloji i dërgesës, andaj nga kjo fletëkthesë nuk mund të konstatohet lloji i dërgesës së dorëzuar debitorit përmes postës.

Andaj duke qenë se nuk ka prova se debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, rezulton se fatura e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale – debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilës Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1855/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.